

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Projektin e Çertifikimit me ISO sipas standardeve ndërkombëtare për Albcontrol Sh.a.”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 22114311-5 Projekte; 72330000 - 2 Shërbimet e standardizimit dhe klasifikimit të përmbajtjes ose të dhënave

Vlera e fondit limit: 91 000 000 (nëntëdhjetë e një milionë) **lekë pa TVSH** ose **927 247** (nëntëqind e e njëzet e shtatë mijë e dyqind e dyzet e shtatë) **Euro pa TVSH**. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën **30/12/2024** është **98.14 Lekë/Euro**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2021, 2022, 2023 të miratuara nga organet përkatëse shtetërore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M. nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata ku të kete realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes dhe të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të ofruara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001: 2015 "Sistemi i menaxhimit të cilësisë"

ISO/IEC 27001:2022 të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

ISO 45001:2018 të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

ISO 20000-1:2018 të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të shërbimeve IT

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

Argumentim: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, shërbimet ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij me kontratë të vlefshme pune (vërtetuar në listëpagesat) ekspertë me eksperiencë prej të paktën 3 vitesh në auditimin e sistemeve, të angazhuar për realizimin e shërbimit (projektit), sipas kualifikimeve të mëposhtme:

- 1 (nje) menaxher ose auditor për Sistemet e Cilësisë / ISO 9001
- 1 (nje) menaxher ose auditor për Sistemet e Mjedisit / ISO 14001
- 1 (nje) menaxher ose auditor për Sistemet e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë / ISO 45001
- 1 (nje) menaxher ose auditor për Sistemet e Sigurisë së Informacionit /ISO 27001
- 1 (nje) menaxher ose auditor për Sistemet e Menaxhimit të Shërbimit IT / ISO 20000-1

Ofertuesi duhet të ketë gjithashtu në stafin e tij me kontratë të vlefshme pune staf me kualifikimet e mëposhtme dhe me një eksperiencë pune të paktën 3 vjet:

- 1 (nje) menaxher ose auditor për SES (Single European Sky - Qielli i Vetëm Europian)

Numri minimal i personelit që do të angazhohet për realizimin e procedurës duhet të jetë 6 persona. Për secilin anëtar të stafit kontraktori duhet të paraqesë:

1. CV
2. Diplomën
3. Kontratën e punës / bashkëpunimit
4. Çertifikatat/Diplomat përkatëse

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë A.K., përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të provojnë se kanë stafin e nevojshëm, personelin e kualifikuar për zbatimin me sukses të kontratës.

Është e drejta e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar që i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

2.3.4 Ofertuesi duhet të sigurojë shërbimet e një ose disa trupave certifikuese të akredituara ndërkombëtarisht kundrejt SES, ISO 9001, ISO 45001, ISO 14001, ISO 27001, ISO 20000-1. Trupat Çertifikuese kombëtare duhet të jenë të akredituara nga DPA ndërsa Trupa/t Çertifikuese të akredituara ndërkombëtarisht, duhet të jenë nënshkruese të marrëveshjes së njohjes reciproke (MLA ose MRA) me Organizmin Europian të Akreditimit (EA) ose me Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF). Për trupën/at certifikuese duhen dëshmuar ekperiencia për certifikime kundrejt standarteve më sipër në fushën e aviacionit civil. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik do të duhet të paraqesë Çertifikata të lëshuara nga Trupa/t Çertifikuese për Agjenci të Menaxhimit të Trafikut Ajror

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i Specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, pjesë e D.T. ngarkuar në S.P.E., për shërbimet objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose**

performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit